

Tensioni në qarqet e rrymës

Shumë paisje shfrytëzojnë energji. Në fotografinë rentgen të llambës së xhepit brenda shihen dy bateri.

Ato janë të lidhura në seri, njëri skaj me skajin tjetër.



Për llambën e xhepit sikurse kjo, duhen dy bateri që do të japin rrymë të mjaftueshme që ajo të ndriçojë.

Tensioni i baterisë


Në bateritë zakonisht shënohet **tensioni** i tyre. Shenja mund të tregojë “1.5 V”. Kjo do të thotë se tensioni baterisë është 1,5 volt.

Volti (simboli V) është njësia për matjen e tensionit.

Për matjen e tensionit shrytëzohet **voltmetri**.


Tensioni i burimit matet në atë mënyrë që voltmetri lidhet paralelisht me burimin, kjo do të thotë se skajet e voltmetrit lidhen me skajet e burimit.

Skaji pozitiv i voltmetrit (ngjyra e kuqe) duhet të lidhet me polin pozitiv të burimit



Tensioni në qarkun serik

Nëse dy apo më tepër bateri lidhen në mënyrë serike, atëherë tensioni i përgjithshëm është shuma e tensioneve të burimeve.



Kujdes! Nëse lidh dy bateri polin pozitiv me polin pozitiv, ndërsa polin negativ me polin negativ, atëherë tensioni i përgjithshëm nuk është shuma e tensioneve të veçanta

Më shumë volt, më shumë amperë

Rritja e tensionit të burimit rrit intensitetin e rrymës në qark. Kjo vjen për shkak se dy bateri të lidhura në mënyrë serike më fuqishëm do ti shtyjë elektronet në tela, ndërsa kjo do të rezultojë me rrymë me intensitet më të madh.

Nëse rryma që rrjedh është më e forte, atëherë llamba do të ndriçojë më fort. Rryma shumë shpejt bart energjinë nga bateria deri te llamba.



Detyrë shtëpie

Faqe 61

Pyetja 1,2,3,4